



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË PËR PERIUDHËN: JANAR – QERSHOR 2016

AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS

TETOR 2016

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. MESATARJA E DITËVE TË NEVOJSHME PËR REGJISTRIMIN E NJË BIZNESI.....	4
III. MESATARJA E DITËVE TË NEVOJSHME PËR REGJISTRIMIN E NJË SHPK-JE.....	6
IV. KOHA E NEVOJSHME PËR REGJISTRIMIN E NJË BIZNESI SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT	7
V. REGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE	8
VI. SHOQËRITË TREGTARE TË ÇREGJISTRUARA	8
VII. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS .	9
VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË	10
IX. PËRFUNDIM.....	12

I. HYRJE

Ky raport është rezultat i vlerësimit të përbashkët të kryer në gjysmën e parë të vitit 2016 nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejme "ARBK") me përkrahjen e Projektit të USAID-it Partneritetet për Zhvillim (në tekstin e mëtejme "USAID PFD") të një sërë indikatorëve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit të biznesit në Kosovë, i kryer në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Ky aktivitet rrjedh nga analiza e indikatorit *Fillimi i një Biznesi* të Raportit të Bankës Botërore për Të Bërit Biznes e kryer si pjesë e reformave të të bërit biznes të nisur nga Qeveria e Kosovës në Dhjetor të vitit 2015. Hartimi i këtij raporti ishte përcaktuar si një prej masave afatshkurta në memorandumun e reformave për indikatorin *Fillimi i një Biznesi*, i përgatitur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Gjatë kësaj periudhe, një ekip i përbashkët i përbërë nga zyrtarët e ARBK-së dhe këshilltarët e USAID PFD kanë analizuar një sërë indikatorësh të lidhur me performancën e ARBK-së, duke përfshirë:

- Koha e nevojshme për regjistrim të biznesit në përgjithësi në Kosovë dhe sipas komunave;
- Numri total i bizneseve të regjistruara sipas formës ligjore dhe sipas komunave;
- Numri total i bizneseve të çregjistruara sipas formës së biznesit dhe sipas komunave;
- Numri total i degëve të kompanive të huaja të regjistruara sipas vendit të origjinës;
- Numri total i femrave që marrin pjesë (si ortak ose aksionarë) në shoqëritë tregtare në Kosovë, dhe
- Numri total i bizneseve individuale në pronësi të femrave.

USAID-i, përmes projektit aktual të tij Partneritetet për Zhvillim, si dhe projekteve të mëparshme në vazhdimësi e ka përkrahur MTI-në dhe ARBK-në përmes përmirësimeve ligjore, trajnimit të stafit, ngritjes së kapaciteteve dhe aktiviteteve tjera që kanë pasur për qëllim përmirësimin e procesit të regjistrimit të biznesit. Këto aktivitete kanë kontribuar në shkurtimin e konsiderueshëm të kohës së nevojshme për regjistrim të bizneseve dhe eliminimin e hapave në procesin e regjistrimit të bizneseve, siç reflektohet në Raportin e Bankës Botërore për Të Bërit Biznes ku rangimi i Kosovës është përmirësuar me 117 vende që nga viti 2010 (nga pozita e 164 në botë në vitin 2014, në pozitën e 47 në botë në vitin 2016).

Një qëllim tjetër i këtij raporti është nisja e asaj që pritet të bëhet proces i rregullt i vlerësimit të performancës së zyrës qendrore të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit që vendimmarrja të bëhet në bazë të informatave të plota me qëllim të përmirësimit të mëtutjeshëm të procesit të regjistrimit të bizneseve i cili është një proces i vazhdueshëm që deri më tani ka rezultuar me shkurtim të kohës së nevojshme për regjistrim dhe eliminim të pengesave të panevojshme për regjistrimin e bizneseve.

Me progresin e procesit të regjistrimit të bizneseve drejt regjistrimit të plotë elektronik, pritet që numri i indikatorëve dhe cilësia e të dhënave do të rritet dhe të pasqyrohet në raportet pasuese.

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i bizneseve të ARBK-së për bizneset që me ligje të veçanta në Kosovë kërkohet të regjistrohen në ARBK. Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare procesi i regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë është akt formal, administrativ dhe informativ. Rrjedhimisht, ky raport nuk bën ndonjë supozim ose ofron shifra të shoqërive tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, dhe në vend të kësaj fokusohet vetëm në shoqëritë tregtare të regjistruara ose çregjistruara në ARBK. Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë,

dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë do të kërkonte përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të parë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera të zbatueshme, ARBK aktualisht regjistron format ligjore të mëposhtme të shoqërive tregtare: Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëri Aksionare, Degët e Kompanive të Huaja dhe Kooperativat Bujqësore.

Për qëllime të këtij raporti, ditët janë llogaritur në bazë të matjes së ditëve kalendarike dhe raporti matë të dhënat e mbledhura dhe përpunuara deri më 30 qershor 2016. Raporti përdor periudhat vijuese kohore për vlerësimin:

Periudhat kohore të vlerësimit	
Koha e nevojitur për regjistrim	1) 1 janar 2010 – 30 qershor 2016 2) 1 janar 2016 – 30 qershor 2016
Numri total i regjistrimeve dhe çregjistrimeve	1) 1 janar 2003 – 30 qershor 2016 2) Shtator 1999 – 30 qershor 2016
Numri total degëve të kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë	1) Shtator 1999 – 30 qershor 2016
Numri total i femrave si pronare individuale ose pjesëmarrja si ortakë ose aksionare në Ortakëri ose korporata	1) Gjysma e 2-të e 2012 – 30 qershor 2016

Ndryshimet në periudhat kohore të vlerësuara ishin të nevojshme për të ruajtur saktësinë e të dhënave ose për shkak të mungesës së të dhënave, p.sh., ARBK ka filluar mbledhjen e të dhënave gjinore vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2012.

II. MESATARJA E DITËVE TË NEVOJSHME PËR REGJISTRIMIN E NJË BIZNESI

Shoqëritë tregtare siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare kërkohet të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 28 qendrat komunale për regjistrimin e bizneseve gjithandej nëpër Kosovë. Kjo pjesë e raportit e matë numrin e ditëve të nevojshme për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

Grafiku I paraqet një pasqyrë të kohës mesatare të nevojshme për regjistrimin e një shoqërie tregtare gjatë periudhës 1 janar 2010 deri më 30 qershor 2016 dhe paraqet mesataren totale të bazuar në regjistrimin e të gjitha formave ligjore të shoqërive tregtare përkundër ndryshimeve të mëdha në kohën e nevojshme për regjistrimin e llojeve të ndryshme, p.sh., koha e nevojshme për regjistrimin e një Biznesi Individual është dukshëm më shkurtë se koha e nevojshme për regjistrimin e një Shoqërie Aksionare.

Siç mund të shihet në Grafikon 1 më poshtë, nga data 1 janar 2010 deri më 30 qershor 2016, numri mesatar i ditëve që nevojiten për regjistrimin e një biznesi në Kosovë ka rënë nga 2.92 në 2.28 ditë, që paraqet një përmirësim prej 21.92% sa i përket kohës së nevojshme për regjistrimin e një shoqërie tregtare gjatë kësaj periudhe.


Grafiku 1: Numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrim të një shoqërie tregtare janar 2010 – 30 qershor 2016:



Vija e kuqe e ndërprere paraqet vitin kur ARBK ka filluar lëshimin e numrit fiskal për shoqëritë tregtare në momentin e regjistrimit të tyre bashkë me Certifikatën e regjistrimit. Para vitit 2012 këtë numër e ka lëshuar nga Administrata Tatimore.

Për më shumë, Grafiku 2 më poshtë tregon se në vetëm gjashtë muaj, 1 janar 2016 deri 30 qershor 2016, numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrim të një biznesi në Kosovë ka rënë nga mesatarja prej 2.56 në 1.59 ditë, që paraqet një përmirësim prej 37.89% sa i përket kohës së nevojshme për regjistrim të një shoqërie tregtare gjatë kësaj periudhe.


Grafiku 2: Numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrimin e një shoqërie tregtare janar 2016 – 30 qershor 2016:



III. MESATARJA E DITËVE TË NEVOJSHME PËR REGJISTRIMIN E NJË SHPK-JE

Si forma më e zakonshme e korporatave, kjo pjesë e raportit analizon kohën e nevojshme për regjistrim të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Grafiku 3 më poshtë tregon se nga data 1 janar 2010 deri më 30 qershor 2016, numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrimin e një SHPK-je në Kosovë është ulur nga mesatarja prej 6.71 në 3.05 ditë, që paraqet përmirësim prej 54.54% sa i përket kohës së nevojshme për regjistrim të një SHPK-je gjatë kësaj periudhe.


Grafiku 3: Numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrimin e një SHPK-je, 2010 – 2016:



Vija e kuqe e ndërprerë paraqet vitin kur ARBK ka filluar lëshimin e numrit fiskal për shoqëritë tregtare në momentin e regjistrimit të tyre bashkë me Certifikatën e regjistrimit. Para vitit 2012 këtë numër e ka lëshuar nga Administrata Tatimore.

Për më tepër, Grafiku 4 më poshtë tregon se në vetëm gjashtë muaj, nga 1 janari 2016 deri më 30 qershor 2016, numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrimin e një SHPK-je është ulur nga mesatarja prej 3.80 në 1.95 ditë, që paraqet përmirësim prej 48.68% sa i përket kohës së nevojshme për regjistrimin e një SHPK-je gjatë kësaj periudhe.

Grafiku 4: Numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrimin e një SHPK-je, 1 janar 2016 – 30 qershor 2016



IV. KOHA E NEVOJSHME PËR REGJISTRIMIN E NJË BIZNESI SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT

Tabela I më poshtë tregon numrin mesatar të ditëve të nevojshme për regjistrimin e një shoqërie tregtare sipas qendrave komunale të regjistrimit të bizneseve gjatë periudhës I janar 2010 deri më 30 qershor 2016. Tabela e shfaqur më poshtë përfshin 28 qendrat komunale për regjistrimin e bizneseve dhe zyrën qendrore të ARBK e cila gjithashtu mbulon komunat e Prishtinës dhe Obiliqit.

Dragashi është qendra komunale për regjistrimin e bizneseve me performancën më të mirë sa i përket ditëve të nevojshme për regjistrimin e një shoqërie tregtare gjatë kësaj periudhe, duke vazhduar pastaj me Istogun, Pejën, Vitinë dhe Klinën.

Tabela I: Numri mesatar i ditëve të nevojshme për regjistrimin e një shoqërie tregtare sipas Qendrave për Regjistrimin e Bizneseve, I janar 2010 – 2016:

Komuna	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Mesatarja
Deçan	2.41	2.22	2.55	2.43	5.35	2.86	1.89	2.84
Dragash	3.75	1.59	1.32	1.17	1.39	2.17	1.80	1.83
Ferizaj	2.53	3.03	2.79	2.48	2.57	2.20	2.08	2.55
Fushë Kosovë	3.30	2.64	2.14	2.35	2.41	3.33	2.68	2.68
Gjakovë	3.00	2.13	2.24	1.90	2.29	2.13	2.04	2.25
Gjilan	2.40	1.95	1.57	1.52	2.00	2.16	2.31	1.97
Gllgoc	2.17	1.98	2.12	1.60	2.55	1.97	1.78	2.03
Graçanicë	4.58	4.91	2.36	2.38	3.09	2.78	2.58	2.85
Hani i Elezit	5.00	1.00	3.00	2.67	7.17	2.98	2.44	3.49
Istog	2.18	1.53	1.60	1.48	2.12	2.15	2.16	1.88
Kaçanik	1.82	2.03	1.77	1.60	2.55	2.42	3.38	2.11
Kamenicë	2.48	2.04	2.22	1.52	1.70	2.24	2.07	2.02
Klinë	2.96	2.72	1.88	1.54	1.73	1.91	1.41	1.96
Lipjan	2.91	2.23	2.33	1.88	2.23	2.17	1.85	2.23
Malishevë	2.64	3.91	1.99	1.54	2.55	3.45	2.15	2.63
Mitrovicë	2.57	2.54	2.79	1.60	1.90	1.74	1.68	2.13
Mitrovicë Veriore	2.36	2.78	2.48	6.83	4.62	3.33	1.92	3.69
Novobërdë	2.00	2.93	3.16	3.76	4.30	3.69	5.38	3.73
Pejë	2.89	2.25	1.55	1.31	2.00	1.78	1.91	1.92
Podujevë	4.13	2.64	2.05	1.45	2.01	1.70	1.51	2.07
Prishtinë (ARBK)	3.43	3.29	2.80	3.00	2.83	3.32	3.06	3.09
Prizren	2.55	2.84	2.19	1.68	2.02	2.01	1.69	2.17
Rahovec	3.28	3.27	2.89	1.82	2.47	1.67	1.53	2.44
Shtërpçë	4.04	4.39	2.46	2.60	2.69	4.93	2.70	3.27
Shtime	2.09	2.09	2.32	2.80	2.34	1.82	1.94	2.21
Skenderaj	2.57	2.62	1.73	1.52	2.27	2.91	2.19	2.16
Suharekë	3.08	2.48	2.63	1.60	3.24	2.30	2.05	2.46
Viti	2.21	2.42	1.83	1.35	1.88	1.99	2.40	1.93
Vushtrri	2.56	2.41	2.28	2.00	2.40	2.25	2.06	2.28

*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të madhe të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të vogël të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

V. REGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE

Tabela 2 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore të shoqërisë tregtare dhe sipas vitit të regjistrimit për periudhën prej vitit 1999 deri më 30 qershor 2016. Kjo tabelë paraqet numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara në vitin e caktuar dhe nuk i pasqyron çregjistrimet të cilat reflektohen në Tabelën 3 më poshtë. Të dhënat tregojnë se forma ligjore e shoqërive tregtare më e regjistruar është Biznesi Individual e ndjekur nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar. Forma ligjore e shoqërive tregtare më së paku e regjistruar është Ortakëria e Kufizuar.

Tabela 2: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe vitit të regjistrimit

Viti	Biznes Individual	Ortakëri e Përgjithshme	Ortakëri e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Shoqëri Aksionare	Degë e Kompanisë së Huaj	Kooperativë Bujqësore	Totali
2003*	47,427	1,425	77	649	284	11	1	49,874
2004	11,374	258	2	745	67	34	9	12,489
2005	7,916	281		752	42	54	20	9,065
2006	5,254	247	5	792	66	50	10	6,424
2007	4,529	244		859	44	57	9	5,742
2008	6,652	314	2	952	39	82	8	8,049
2009	6,313	226		899	18	111	5	7,572
2010	6,460	209	1	1,014	21	94	6	7,805
2011	6,550	203		1,113	14	59	1	7,940
2012	7,930	181	2	1,477	31	70	8	9,699
2013	7,373	113		1,982	18	42	4	9,532
2014	7,355	91	1	2,125	29	66	4	9,671
2015	7,385	78		2,527	27	50	8	10,075
2016	3,600	27		2,123	12	23	2	5,787
Total	136,118	3,897	90	18,009	712	803	95	159,724

*Numri total i shoqërive tregtare i regjistruar në vitin 2003, siç është paraqitur në Tabelën 2, përfshin 43,796 shoqëri tregtare të regjistruara nga viti 1999 deri me 21 Shkurt, 2003 dhe 6,078 shoqëri tregtare të regjistruara gjatë periudhës 22 Shkurt 2003 deri me 31 Dhjetor 2003.

VI. SHOQËRITË TREGTARE TË ÇREGJISTRUARA

Tabela 3 paraqet numrin e shoqërive tregtare të çregjistruara në ARBK nga viti 1999 deri më 30 qershor 2016 sipas formës ligjore të shoqërisë tregtare dhe sipas vitit të çregjistrimit. Procesi i çregjistrimit të shoqërive tregtare, për qëllime të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe këtij raporti nënkupton çregjistrimin e shoqërisë tregtare nga regjistri i ARBK, që rezulton në përfundimin e ekzistimit të shoqërisë tregtare si entitet i veçantë. Çregjistrimi nga regjistri i ARBK, në shumicën e rasteve bëhet pas shuarjes vullnetare të shoqërisë tregtare, mirëpo mund të jetë edhe i detyrueshëm, si rezultat i procedurave të falimentimit ose sipas vendimit të gjykatës në pajtim me ligjin e aplikueshëm. Numri më i madh i bizneseve të çregjistruara janë Bizneset Individuale, me në total 12,761 Biznese Individuale të çregjistruara gjatë kësaj periudhe, ndërsa forma ligjore e shoqërive tregtare më e çregjistruar është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me 474 SHPK të çregjistruara.

Tabela 3: Numri i shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës ligjore dhe sipas vitit të çregjistrimit

Viti	Biznes Individual	Ortakëri e Përgjithshme	Ortakëritë e Kufizuara	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Shoqëri Aksionare	Degë e Kompanisë së Huaj	Kooperativë Bujqësore	Totali
1999-2007*	1,476	23		9				1,508
2008	652	24		15	3	5		699
2009	1,051	29		20	6	4		1,110
2010	1,324	52		78	11	3		1,468
2011	861	38	1	39	2	12	1	954
2012	1,026	39		54	3	5		1,127
2013	1,426	37		48		8		1,519
2014	1,538	45		74	4	24	1	1,686
2015	2,095	43		80		15		2,233
2016	1,312	19		57			1	1,389
Total	12,761	349	1	474	29	76	3	13,693

*Të dhënat për numrin total të shoqërive tregtare të çregjistruara nga viti 1999 deri më 2007, janë migruar në bazën e të dhënave të ARBK-së në vitin 2007. Të dhënat në këtë tabelë për vitin 2007 përfshijnë shoqëritë tregtare të regjistruara nga viti 1999 deri më 2007.

VII. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kompania e huaj përkufizohet si një shoqëri tregtare që është themeluar dhe aktualisht ekziston sipas një ligji të një juridiksioni jashtë Kosovës dhe e cila mund të angazhohet në aktivitete afariste në Kosovë përmes regjistrimit të një dege në Kosovë në ARBK. Tabela 4 më poshtë tregon numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, sipas vendit të origjinës nga viti 1999 deri më 30 qershor 2016.

Tabela 4: Degët e kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë

Nr.	Shteti	Degët e Kompanive të Huaja
1.	Shqipëria	168
2.	Maqedonia	58
3.	Gjermania	58
4.	Zvicra	51
5.	Turqia	50
6.	Shtetet e Bashkuara	38
7.	Sllovenia	38
8.	Kroacia	35
9.	Italia	31
10.	Serbia	19
11.	Bosnja dhe Hercegovina	19
12.	Mbretëria e Bashkuar	19
13.	Bullgaria	15
14.	Austria	8
15.	Greqia	8
16.	Mali i Zi	7
17.	Holanda	7
18.	Hungaria	7
19.	Franca	6


20.	Danimarka	5
21.	Suedia	5
22.	Belgjika	4
23.	Republika Çeke	4
24.	Rumania	3
25.	Spanja	3
26.	Sllovakia	2
27.	Norvegjia	2
28.	Irlanda	2
29.	Polonia	2
30.	Kanada	2
31.	Ishujt Marshall	2
32.	Sejshelet	1
33.	Kenia	1
34.	Malta	1
35.	Panama	1
36.	Finlanda	1
37.	Luksemburgu	1
38.	Bahamet	1
39.	Portugalia	1
40.	Qipro	1
41.	Belize	1
42.	Islanda	1
43.	San Marino	1
44.	Afganistani	1
45.	Ishujt Kajman	1
46.	Letonia	1
47.	Ishujt e Virgjër, Britanez	1
48.	Lihtenshtajni	1
49.	Lituania	1
	Totali	696

VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË

Të dhënat në Grafikon 5 dhe 6 paraqesin pjesëmarrjen gjinore në shoqëritë tregtare të regjistruara nga gjysma e dytë e vitit 2012 deri më 30 qershor 2016, duke pasur parasysh që ARBK filloi regjistrimin e gjinisë së pronarëve, ortakëve dhe aksionarëve nga gjysma e dytë e vitit 2012. Për shkak të natyrës së ndryshme të formave ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat e mëposhtme paraqiten ndaras për Bizneset Individuale në pronësi të femrave, që zakonisht janë pronësi individuale të vogla me pronar të vetëm, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku femrat marrin pjesë si ortakë ose aksionare në shoqëri tregtare më të mëdha ose më diverse.


Si forma më e zakonshme e shoqërisë tregtare në Kosovë, Grafiku 5 më poshtë matë përqindjen e pronareve femra të Bizneseve Individuale. Edhe pse ende është në nivel relativisht të ulët, të dhënat tregojnë një trend në rritje të regjistrimit të Bizneseve Individuale nga femrat.

Grafiku 5: Përqindja e Bizneseve Individuale sipas Gjinisë



Grafiku 6 reflekton përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë, në shoqëritë tregtare me përfshirje të bizneseve individuale, të regjistruara në Kosovë. Edhe pse pjesëmarrja e femrave si ortakë dhe aksionare është ende relativisht e ulët, të dhënat tregojnë një trend në rritje të pjesëmarrjes së tyre.

Grafiku 6: Përqindja e Ortakëve dhe Aksionarëve sipas Gjinisë



IX. PËRFUNDIM

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në mënyrë që të përmirësoj akoma më shumë efikasitetin e regjistrimit në ARBK ka ndërmarrë një sërë veprimesh:

- Ka iniciuar zhvillimin, institucionalizimin dhe përdorimin e rregullt të matjeve të performancës duke i nxjerrë nga të dhënat zyrtare të regjistrimit për të monitoruar kohën për përpunimin e aplikacioneve për regjistrim nëpër qendrat komunale të regjistrimit dhe për të identifikuar performuesit më të mirë dhe ata më të përmirësuarit;
- Ka rritur fokusin në sigurimin e pajtueshmërisë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- Ka thelluar koordinimin ndërmjet Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës për të përmirësuar kohën e procesit të regjistrimit të aplikacioneve dhe lëshimin e numrave identifikues tatimor në qendrat e regjistrimit të ARBK-së, duke përfshirë zhvillimin dhe ekzekutimin e një Memorandumi formal të Mirëkuptimit ndërmjet ARBK-së, ATK-së dhe Ministrisë së Administratës Publike për bashkëpunim më të thellë dhe të vazhdueshëm në Qershor të vitit 2016. Sistemet e ARBK-së dhe ATK-së janë plotësisht të integruar;
- Ka zhvilluar programe trajnimi gjithëpërfshirëse për shërbimin ndaj klientëve me të gjithë stafin e ARBK-së dhe të qendrave komunale të regjistrimit të bizneseve.

Metodologjia e përdorur për zhvillimin e këtij raporti pritet të përsëritet nga ARBK dhe të rezultojë me publikim të raporteve të rregullta të matjes së performancës të përgatitura dhe publikuara nga ARBK për të shërbyer si mjet informues për përmirësimet e mëtutjeshme të procesit. Partneritetet për Zhvillimi të USAID-it do të vazhdojnë të përkrahin këtë qasje deri në institucionalizimin e plotë.

Në të ardhmen, është gjithashtu qenësore që Projektligji i ri për Shoqëritë Tregtare i cili aktualisht është duke u hartuar në MTI, të përfshijë parimet e njëjta të Ligjit aktual për Shoqëritë Tregtare sa i përket regjistrimit të bizneseve, pra që regjistrimi i biznesit është proces formal administrativ, i cili nuk imponon pengesa dhe barrë për bizneset që duan të regjistrohen në ARBK.